



**AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM  
KOSOVO ACCREDITATION AGENCY  
AGENCIJA ZA AKREDITOVANJE KOSOVA**

Student's Center, 2<sup>nd</sup> floor, 10000 Prishtina, Kosovo, tel. +381 38 213722, fax +381 38 213087  
www.akreditimi-ks.org, email: kaaoffice@gmail.com

Nr. 725/14 Dt. 28.08.2014

Në mbështetje të nenit 145, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, mori:

**V E N D I M**

I. Aprovohet kërkesa e Kolegjit "AUK" për ofrimin e programeve të studimit të Rochester Institute of Technology (RIT) për periudhën 5 vjeçare, 1 Tetor 2014 – 30 Shtator 2019:

- **Bachelor i Shkencës në Artet dhe Shkencat e Aplikuara**

Koncentrimet profesionale të programit përfshijnë:

- Ekonomi e statistika
- Menaxhment
- Politika Publike
- Multimedia dhe Komunikim Vizual
- Teknologjia Informative
- Multimedia dhe Dizajnim në Rrjet

Koncentrimet minore të programit përfshijnë:

- Ekonomi
- Marrëdhëniet Ndërkombëtare
- Studimet juridike

- Politika Publike

## **A r s y e t i m**

- II. Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, dhe sqarimeve shtesë të dhëna nga Rochester Institute of Technology (RIT) dhe Kolegji Amerikan në Kosovë rreth statusit ligjor të bashkëpunimit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.
  
- III. Ndaj këtij vendimi lejohet kërkesa për rishqyrtim të vendimi të KSHC-së brenda afatit të paraparë ligjor.
  
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi u dërgohet:**

- Kolegjit "AUK"
- Arkivit të AKA-së

  
  
**Dr.sc. Ferdije Zhushi Etemi**  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë